VENDIM
Nr. 54, datë 5.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN
E RAJONEVE NR. 13, DATË 6.8.2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve", bëhet ndryshimi, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr.13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.9, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi, i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i urës së Zvërnecit	1 500 000	1 500 000	0

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban nr.3961 prot, datë 12.07.2016.
2. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2014 dhe 2015, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.13, datë 6.08.2014 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Në lekë)
	TOTALI		604 542 704	252 252 844	352 259 860

3. Numri rendor i totalit të projekteve në tabelën 1 të këtij vendimi, ndryshon nga 11 projekte bëhet 10 projekte dhe rinumërimi përkatës.